



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1069/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Dr.sc.Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Mehdi Kuqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Junik, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Junik, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Mehdi Kuqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Junik, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Junik, me shenjën ZL.An.1069/2017 e datës 13.11.2017, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 përmes dërgesës postare ka pranuar një apel nga Mehdi Kuqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Junik, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Junik, i njejtë i protokolluar me datë 13.11.2017 në ora 11:00, ka pretenduar se në Qendrën e Votimit votat me kusht nuk janë numëruar sakt, duke theksuar se ka pasur 60 vota, duke shtuar se vota e nënës sime e njëjta ka votuar me kusht në vendvotimin VVnr. 3101C/07D nuk i është numëruar saktë dhe nga ky veprim jamë i dëmtuar me 1 votë. Më tutje ka theksuar se votuesve me kushte nuk i është numëruar vota me kushte dhe jamë dëmtuar me një votë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së apelit dhe vlerësimit e shkresave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara pasi që parashtruesi i apelit nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apellesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, refuzoj si të pabazuar apelin e apellesit .


Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.1069/2017 më datën 13.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Dr.sc. Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*